



PRESS RELEASE

Bashkia e Lezhës Nis Sistemin e Kompjuterizuar të Taksave

10 nëntor 2009 Bashkia e Lezhës, me mbështetjen e Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) përuroi sot një sistem të ri të kompjuterizuar të taksave vendore. Sistemi i ri i taksave mundëson një administrim më të efektshëm dhe më efikas të vjeljes së taksave dhe ofrimit të shërbimeve që do të rezultojnë në të ardhura më të mëdha nga taksat për bashkinë dhe në shërbime më të mira për qytetarët e Lezhës.

Programi USAID/LGPA ofroi asistencë teknike si dhe mbështetje materiale për Drejtorinë e Taksave në Bashkinë e Lezhës, përfshirë këtu mbi 3.6 milionë lekë si në pajisje ashtu edhe në programe kompjuterike. Me këtë mbështetje, Programi LGPA po ndihmon në përmirësimin e cilësisë së qeverisjes vendore. Kompjuterizimi i Drejtorisë së Taksave në Bashkinë e Lezhës do të sjellë si rezultat:

- *Qeverisje më të mirë vendore:* Kompjuterizimi i funksioneve, që aktualisht bëhen në mënyrë manuale, do të ulë kohën që duhet për të llogaritur saktësisht detyrimet tatimore, për të evidentuar pagesat e taksave si dhe për të hartuar parashikimet e të ardhurave. Vendimmarrësit në bashki tashmë do të jenë në gjendje të hartojnë raporte më të mira dhe më të shpeshta si dhe të analizojnë të ardhurat nga taksat (përfshirë këtu burimin {sipas taksës specifike dhe tipit të taksapaguesit}, përqindjen totale të vjelur si dhe detyrimet e mbetura).
- *Shërbime më të mira për konsumatorin:* Përmirësimi i qeverisjes vendore do t'i mundësojë bashkisë ofrimin e shërbimeve më të mira për komunitetin. Duke përdorur programin e ri kompjuterik, Lezha do të jetë në gjendje të vjelë më shumë të ardhura nga taksat si dhe të hartojë buxhete më të sakta dhe më të plota të shërbimeve bashkiake për qytetarët e saj.
- *Ulje të korrupsionit dhe gabimeve:* Kompjuterizimi i menaxhimit financiar dhe i sistemit të taksave do të rrisë monitorimin dhe vlerësimin, do të ulë gabimet që bëhen me dorë si dhe pakësojë ndërveprimet personale me punonjësit e tatimeve që shpesh konsiderohen si burim i praktikave korruptive.

Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) punon me bashkitë partnere në Shqipëri për nxitjen e zhvillimit të ekonomisë vendore, për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe për fuqizimin e pjesëmarrjes dhe angazhimit të së shoqërisë civile dhe të sektorit privat në zhvillimin vendor. Përveç Lezhës, Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri do të prezantojë sistemin e kompjuterizuar të taksave edhe në Elbasan, Fier, Fushë-Krujë, Gramsh, Korçë, Kukës, Librazhd, Pogradec dhe Shkodër. Mbështetja e USAID-it për kompjuterizimin e drejtorive të taksave në bashkitë partnere arrin vlerën e 36,700,000 Lekë.

Për më shumë informacioni lutemi kontaktoni: Silvana Meko, Specialiste e Qeverisjes Vendore, Cel: 0694033831, email: smeko@lgpa.al ose telefon zyre: ++355-4-266-637, ose në internet në adresën: www.lgpa.al